

# FINANCA

Balotina Maja | PRILL 2026



## MINISTRI MALAJ, KONFERENCË PËR PREZANTIMIN E PERFORMANCËS FISKALE-EKONOMIKE PËR JANAR-MARS 2026

Ministri i Financave, Petrit Malaj, paraqiti gjatë një konferencë për media performancën fiskale-ekonomike për janar-mars 2026, e cila dëshmon menaxhim të kujdesshëm financiar dhe efektet konkrete të politikave që garantojnë rritje të qëndrueshme ekonomike. Të ardhurat totale për

periudhën Janar-Mars 2026 arritën në 205.1 miliardë lekë, rreth 250 milionë euro më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë ose 110 milionë euro më shumë në krahasim me planin për tremujorin e parë të vitit 2026. Ministri theksoi se rritja e të ardhurave nuk ka ardhur si rezultat i rritjes së taksave, por si rezultat miradministrimit tatimor dhe doganor, si dhe implementimit më korrekt të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave.

LEXO MË SHUMË

## MINISTRI MALAJ NË TAKIMET E PRANVERËS TË FMN DHE BB NË UASHINGTON, VLERËSOHET QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE FORCIMI I FINANCEVE PUBLIKE

Ministri Petrit Malaj mori pjesë në Takimet e Pranverës të FMN dhe Bankës Botërore në Uashington, SHBA, ku u vlerësua qëndrueshmëria e ekonomisë shqiptare përballë krizave të fundit globale dhe ruajtja e stabilitetit financiar. Gjatë takimeve, z. Malaj prezantoi treguesit kryesorë makroekonomikë dhe financiarë,

duke theksuar rolin e politikave të kujdesshme ekonomike dhe menaxhimit të përmirësuar fiskal në forcimin e financave publike. Si rezultat i konsolidimit fiskal, borxhi publik ka ndjekur një trajektore rënës, duke arritur në 52.9% të PBB-së në fund të vitit 2025, nga 65% në vitin 2019. Ministri Malaj vlerësoi partneritetin e qëndrueshëm me FMN dhe Bankën Botërore, si një mbështetje e rëndësishme për avancimin e reformave ekonomike, forcimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe zbatimin e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit.

LEXO MË SHUMË



## AKT NORMATIV PËR ULJEN E AKCIZËS SË KARBURANTEVE, I PËRGJIGJEMI RITJES SË ÇMIMEVE DHE MBROJMË KONSUMATORËT

Qeveria shqiptare ka miratuar një Akt Normativ për uljen e akcizës së karburanteve, në përgjigje të situatës së rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e konfliktit në Iran. Gjatë një deklarate për mediat, Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, informoi se akciza do të ulet me 20% në rast se çmimi i shitjes me pakicë, i përcaktuar nga Bordi i Transparencës, tejkalon 220 lekë/litër për naftën dhe 200 lekë/litër për benzinën. Ministri tha se masa do të jetë në fuqi deri në stabilizimin e situatës ndërkombëtare, ndërsa garantoj se qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të mbrojtur qytetarët dhe ekonominë nga efektet financiare të kësaj krize, duke garantuar njëkohësisht stabilitetin e buxhetit të shtetit.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI PETRIT MALAJ TAKOHET ME PËRFAQËSUES TË DIASPORËS SHQIPTARE NË UASHINGTON DC

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, zhvilloi një takim me përfaqësues të diasporës shqiptare që jetojnë dhe punojnë në Uashington DC, profesionistë të angazhuar në institucione financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore, FMN dhe IFC. Gjatë këtij takimi, i cili u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi të hapur, u diskutua

mbi rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të diasporës në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe u theksua fakti se sot diaspora përfaqëson shumë më tepër sesa një burim remitancash, duke u shndërruar në një partner strategjik me vlera të shtuara në dije, përvojë, rrjete profesionale dhe potencial konkret për të kontribuar në ekonominë kombëtare. Gjithashtu, u u shpreh mirënjohje për kontributin dhe përfaqësimin dinjitoz të shqiptarëve kudo në botë, duke vlerësuar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në forcimin e lidhjeve ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

LEXO MË SHUMË



## TAKIM ME BIZNESE TË SEKTORIT TË TURIZMIT NË BERAT, FOKUS DEKLARIMI REAL I PAGAVE, FORMALIZIMI I SEKTORIT DHE KONKURRENCA E NDRERSHME

Ministri i Financave zhvilloi një takim me subjekte që operojnë në sektorin e turizmit në qytetin e Beratit, ku u diskutua mbi problematika dhe sfida me të cilat përballen këto subjekte gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, bashkëpunimin me Administratën Tatimore dhe ecurinë e zbatimit të planit

operacional për sektorin e turizmit në rajonin e Beratit. Ministri Malaj vuri në dukje ndikimin e sektorit të turizmit në ekonominë kombëtare, rëndësinë formalizimit real të tij, rritjen e deklarimit të pagave reale, gjë që përkthehet në rritje të mirëqenies për punonjësit dhe më shumë siguri për të ardhmen e tyre. Duke iu referuar qytetit të Beratit, z. Malaj tha se ai përbën një histori suksesi në zhvillimin e turizmit gjatë gjithë vitit, megjithatë, duhet një angazhim më i madh për të garantuar konkurrencë të ndershme, rritje të cilësisë së shërbimeve dhe përmirësim të nivelit të pagave.

LEXO MË SHUMË



## VIZITË PUNE NË DEGËN DOGANORE HANI I HOTIT, FOKUS MODERNIZIMI I ADMINISTRATËS DHE LEHTËSIMI I PROCEDURAVE

Ministri i Financave zhvilloi një vizitë pune në pikën doganore Hani i Hotit, ku u njoh nga afër me aktivitetin e përditshëm të degës doganore, procesin e përpunimit të deklaratave doganore dhe masat që po merren për lehtësimin e skanimit të mallrave dhe mjeteve, me qëllim rritjen e sigurisë, shpejtësisë së përpunimit dhe transparencës së procedurave. Ministri Malaj theksoi se rëndësinë e modernizimit të administratës doganore dhe lehtësimit të procedurave për biznesin, sidomos sa i përket kontrollit të importeve dhe eksporteve, për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë. Aktualisht vendi po zbaton një model evropian, i cili synon një doganë të shpejtë, transparente dhe të besueshme, duke përdorur teknologjinë e informacionit, analizën e të dhënave dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI I FINANCEVE ZHVILLON NJË TAKIM ME SUBJEKTE TË SEKTORIT TË NDËRTIMIT NË SHËNGJIN

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim me përfaqësues të subjekteve që operojnë në sektorin e ndërtimit në Shëngjin, Lezhë. Ministri Malaj theksoi se ndërtimi përbën një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomikë të vendit dhe në këtë drejtim është shumë e rëndësishme formalizimi i tij dhe deklarimi i pagave reale në këtë sektor, si një element kyç për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e të ardhurave në buxhet dhe garantimin e pensioneve dhe sigurisë sociale për punonjësit. Referuar të dhënave, rajoni i Lezhës ka pasur një refleksim pozitiv sa i takon pagave në fashën 100.001 – 120.000 lekë, me rritje 134%. Synimi i qeverisë, tha z. Malaj, nuk është rritja e barrës fiskale për biznesin, por mbështetja dhe lehtësimi i tij, e në këtë kuptim barra ekzistuese duhet të shpërndahet në mënyrën drejtë, në mënyrë që ata që janë korrektë të mos penalizohen nga ata që nuk janë.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRIA E FINANCEVE AVANCON NË PROCESIN E ÇELJES SË FONDEVE TË PROGRAMIT IPARD III

Ministria e Financave përmbylli me sukses përgatitjen e paketës së akreditimit për Programin IPARD III, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt aksesimit të fondeve të Bashkimit Evropian për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Paketa e dorëzuar përfshin kërkesën për besimin e detyrave të zbatimit buxhetor, të shoqëruar

me prova të detajuara mbi përbushjen e kriterëve të përcaktuara nga Komisioni Evropian. Dorëzimi i kësaj pakete përbën një moment kyç në përgatitjet për çeljen e fondeve të IPARD III, e cila synohet të realizohet gjatë vitit 2026. Në vijim, procesi do të hyjë në fazën e vlerësimit nga shërbimet e Komisionit Evropian (DG AGRI), që përfshin analizën e detajuar të dokumentacionit dhe verifikime të mundshme në terren. Kjo fazë parashikohet të zhvillohet gjatë tremujorit të dytë të këtij viti.

LEXO MË SHUMË

## KUVEND, MIRATOHET PROJEKTLIGJI "PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SHUMËPALËSHE PËR LEHTËSIMIN E ZBATIMIT TË SHTYLLËS SË DYTË SUBJEKT I RREGULLIT TATIMOR

Ministri Petrit Malaj prezantoi në Kuvend projektligjin "Për ratifikimin e Konventës shumëpalëshe për lehtësimin e zbatimit të shtyllës së dytë subjekt i rregullit tatimor". Projektligji përbën një dëshmi konkrete se Shqipëria vepron në mbrojtje të interesave të saj, në një kohë që

globalizimi dhe digjitalizimi i ekonomisë ka diktuar nevojën për një reformë të thellë ndërkombëtare të sistemit tatimor. Reforma njihet ndryshe si zgjidhja me dy shtylla ku shtylla e parë fokusohet te ndarja e të drejtave të tatimit midis vendeve, ndërsa shtylla e dytë vendos një nivel minimal tatimi global. Ratifikimi i Konventës i hap rrugën zbatimit të shtyllës së dytë dhe një elementi të rëndësishëm si "Subject to Tax Rule" (STTR), i cili është një mekanizëm që mbron të drejtën e vendeve për të taksuar të ardhurat ndërkufitare, kur ato taten në nivele shumë të ulëta në juridiksione të tjera.

LEXO MË SHUMË



## KUVEND, MIRATOHET PROJEKTLIGJI PËR FORCIMIN E KUADRIT LIGJOR KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Ministri i Financave prezantoi në Kuvend projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar". Ai synon jo vetëm përmirësimin e

mekanizmave ekzistues, por edhe harmonizimin e plotë të legjislacionit tonë me përditësimet më të fundit të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. Projektligji sjell një sërë masash të reja, ndër të cilat përfshirja e konceptit të financimit të armëve të dëmtimit në masë, forcimi i qasjes së bazuar në rrezik për subjektet raportuese, përmirësimi i mekanizmave për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve, si dhe rritja e bashkëpunimit ndër-institucional.

LEXO MË SHUMË